VENDIM
Nr. 35, datë 9.3.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e "draftlicencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsu-matorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti